

ZKM ALBANIA

I/2024



- 1993:** Themelohet në Tiranë Fondacioni Zoja e Këshillit të Mirë.
- 1995:** Poliklinika Atë Luigji Monti fillon veprimtarinë.
- 2004:** Hapet Universiteti Katolik.
- 2008:** Hapet Qendra e Fizioterapisë dhe e Klinikës Dentare
- 2022:** Fillon misioni i Spitalit të ri Katolik ZKM.
- 2024:** **ZKMA**lbania, me këtë revistë të përmuajshme rrëfjëmë histori dhe ushqejmë ideale.

Notizie dalla Fondazione
NOSTRA SIGNORA DEL BUON CONSIGLIO, Tirana

Lajme nga Fondacioni
ZOJA E KËSHILLIT TË MIRË, Tiranë

Redaksia "ZKM ALBANIA" 📍 Kompleksi Spitalor Universitar "Zoja e Këshillit të Mirë" Rr. "Dritan Hoxha", Tiranë
📱 unizkkm 📧 unizkkm 🌐 www.unizkkm.al / Per kontakti 📧 pr@fzkm.org

🗨️ DITËLINDJET

Fondacioni mbushi tridhjetë vjet.

Mbërrin në vitin 2024, ditëlindja e Universitetit (20 vjet) dhe e Qendrës Universitare të Gjuhëve (10 vjet). Koha në këtë mënyrë mat epokën e institucioneve, por është jeta ajo që i jep kuptim fazave të ndryshme të ekzistencës. Ashtu siç ndodh edhe tek njerëzit: fëmijëria, rinia, mosha e rritur apo dhe mosha e tretë ku çdo periudhë ka rëndësinë e vet. Çfarë po ndryshon për Fondacionin tonë?



🗨️ NJË PROJEKT BASHKËPUNIMI MIDIS SHQIPËRISË DHE ITALISË




Ministri i Punëve të Jashtme të Republikës së Italisë, Antonio Tajani, vizitoi Fondacionin në datë 22 dhjetor.

Takimi me anëtarë të ndryshëm të Universitetit dhe të Spitalit ishte miqësor. Ministri foli me drejtuesit për të mësuar më shumë rreth nismës, cilësinë e së cilës e vlerësoi dhe mbajti më pas një fjalim në sallën "Aula Magna". Ishte rasti i përshtatshëm për të paraqitur rëndësinë kulturore të një projekti bashkëpunimi midis Shqipërisë dhe Italisë që është zhvilluar për tridhjetë vjet dhe ende shpreh potencial të dukshëm.

PA KUFIJ

Më 29 mars 2003, në spitalin e Bangkokut, ndërron jetë nga Sars-i, mjeku Carlo Urbani.



Ishite i pari që identifikoi Koronavirusin e formës atipike dhe të rrezikshme të pneumonisë. Metoda e kërkimit e zhvilluar nga Urbani në vitin 2003 ka qenë thelbësore në strategjitë e luftës kundër Koronavirusit të ri Covid-19. U dërgua në Kamboxhia dhe në Vietnam dhe u zgjodh president i sektorit italian të organizatës Mjekë Pa Kufij, ku mori dhe çmimin Nobel për Paqe në vitin 1999 për këtë organizatë. U punësua më pas nga Organizata Botërore e Shëndetësisë si koordinator në azinë Jug-Lindore. Libri që ne veçojmë ofron një lexim stimulues për ta menduar mjekësinë në dimension njerëzor. **“Mjeku duhet të përshkruajë edhe veten”**, ka shkruar Urbani me një vizion komunitar për profesionin e mjekësisë, në mënyrë që “të mund të kontribuojë në rindërtimin e një strukturë shoqërore bazuar në etikën e punës, respektit dhe shpresës”.

MANZONI

“Quarantana” bëri bum në Tiranë.

Bëhet fjalë për botimin e romanit **“I promessi sposi”** nga Alessandro Manzoni i vitit 1840. Gjatë këtij eventi mjaft të ndjekur dhe në prani të ambasadorit italian Fabrizio Bucci, u dhura ky vëllim nga fr. Ruggero Valentini, i cili e merre gjithmonë me vete gjatë transferimeve të tij. Tani, më në fund, vepra më e rëndësishme e letërsisë italiane moderne “prehet në paqe” në Bibliotekën e universitetit.



MJEKËT

Një fushatë për mjekët e "familjes": në vazhdim të nismës globale pas apelit të Papës.



Fushata e parë globale në favor të rolit të **mjekut të përgjithshëm** ka sloganin "Faleminderit doktor" (www.thankyoudoctor.org). Ajo trajton shqetësimin e shprehur nga Papa Françesku në përpjekjen për t'iu përgjigjur krizave në sistemin e kujdesit shëndetësor në shumë vende.

Fushata dhe Deklarata mbështeten nga Akademia Papnore për Jetën, si dhe nga organizata të tjera mjekësore, infermieristike, qytetare dhe akademike. Objektivi i Deklaratës është të rivendosë në qendër të vëmendjes **marrëdhënien mjek-pacient**, pasi mjekët kontribuojnë në ngritjen e sistemit shëndetësor të parandalimit, duke bërë të mundur ndërhyrjet para se gjendja e pacientit të jetë përkeqësuar, dhe të ketë kosto njerëzore dhe sociale.

"Deklarata për rizbulimin e mjekut të familjes" gjendet në tre gjuhë në faqen e fushatës dhe mund të nënshkruhet nga shoqata, grupe, qytetarë, me qëllim njohjen e rolit të përditshëm të miliona mjekëve. Fondacioni i bashkohet kësaj nisme.



SPITALI REND

I hapur një vit më parë është tashmë në zemrat e shumë njerëzve.

I frymëzuar nga Nënë Tereza dhe i ndërtuar nga komuniteti i At Montit, spitali është një mundësi shërbimi mjekësor e konsiderueshme për popullsinë shqiptare, dhe jo vetëm. I ndërtuar nga disa kompani nga të dyja anët e Adriatikut ai përfaqëson një xhevahir të Fondacionit. Është i pajisur me një sallë operative të një standarti të shumë të lartë, të pajisur mirë dhe me shumë hapësirë. Një grup profesionistësh në rritje është protagonist me Fondacionin për këtë fillim që sigurisht nuk ishte i lehtë. Në pritje që kjo strukturë të vlerësohet për të gjithë qytetarët për për shkak të natyrës së saj si ent jo fitimprurës.

www.zoja.al

ALUMNI

Një mundësi e bukur për të bashkëndarë.



Ritakimet janë gjithmonë një mundësi e mire për të ndarë kujtimet dhe përvojat. Në datë 6 dhjetor, në takim vjetor ishte rektori i ri prof. Leonardo Palombi që bëri përshëndetjet mirëpritëse për "ish studentët".

Të diplomuarit që duan të mbajnë kontaktet mund të shkruajnë në adresën:
✉ job.placement@unizkm.al

ENGLISH: I LIKE

Që nga ky vit, programi i mjekësisë flet edhe anglisht.

Programi i studimit të Mjekësisë dhe kirurgjisë realizohet edhe në gjuhën angleze dhe ka pasur një reagim dukshëm të favorshëm nga ana e studentëve.

Ende vazhdon ndërkohë në numër shumë të lartë opsioni për programin në gjuhën italiane.

Universiteti në këtë mënyrë ka realizuar një hap të mëtejshëm duke e bërë kampusin "global", ku shqipja ofrohet si një gjuhë mikpritëse.





QËNDRUESHMËRI

E ardhmja është tani.

Impianti i ri fotovoltaik i realizuar nga Fondacioni ZKM është një shembull konkret i tranzicionit energjistik në respekt të mjedisit dhe të njeriut që jeton në të.

Impianti i ri i prodhimit të energjisë, i besuar kompanisë "Albesol", operacionale në Tiranë që nga viti 2006, do t'i shërbejë jo vetëm Universitetit, por edhe Spitalit.

Kjo nismë është në përputhje me mesazhin e Papa Françeskut në favor të kujdesit për shtëpinë e përbashkët, pra tokës.

SFIDAT E PAQES

Potencial dhe përgjegjësi MESAZHI I 2024 nga Papa Françesku.

Për në datë 27 shkurt, 2024 është programuar një konferencë mbi një temë shumë aktuale - trajtuar nga Papa Françesku në mesazhin për Ditën Botërore të Paqes 2024 – e cila trajton marrdhënien midis inteligjencës artificiale dhe promovimit të paqes.

Konferenca vjetore është kthyer në një traditë në Universitetin tonë, e hapur për studentët, pedagogët, bashkëpunëtorët dhe për të gjithë promotorët e paqes.

Ndër relatorët që do të marrin pjesë në konferencë janë: **IMZOT VINCENZO PAGLIA**, President i Akademisë për Jetën në Vatikan; **NELLO SCAVO**, korrespondent i gazetës "Avvenire" (Milano); **BRANDO BONIFEI**, Relator i ligjit mbi inteligjencën artificiale në pritje të miratimit nga Parlamenti Evropian, i pari në botë.

Konferenca do të mbahet në sallën "Aula Magna", Universiteti Katolik ZKM.

Detaje të tjera dhe programi do të jenë të disponueshme në web: www.unizkm.al

UNIVERSITÀ CATTOLICA
NOSTRA SIGNORA DEL BUON CONSIGLIO

57^a
**GIORNATA
MONDIALE
DELLA PACE**

< Riflettere e condividere
il **MESSAGGIO DI PAPA FRANCESCO**
PER LA CELEBRAZIONE DELLA
GIORNATA MONDIALE DELLA PACE 2024

Intelligenza artificiale e pace

NË SHKURT...



AT BENNY VIZITON FONDACIONIN ZKM

At Benny Mekkat që nga viti 2022 është drejtues i përgjithshëm i Komunitetit fetar themeluar nga i lumi Luigi Monti dhe promotor i Fondacionit ZKM.

Me origjinë indiane, i formuar si infermier në Filipine, ka ushtruar më vonë shërbimin e tij si prift në SHBA, si kapelan i burgjeve, i spitaleve dhe si famullitar.

Me rastin e festës së Zojës së Papërlyer (8 Dhjetor) bëri një vizitë vëllazërore në komunitetin e tij në Tiranë dhe takoi bashkëpunëtorë të aktiviteteve të ndryshme akademike dhe shëndetësore. At Benny shprehu habinë e tij për nismat e ndërmarra në dobi të popullsisë shqiptare, duke inkurajuar përmirësimin e aspekteve më të dobëta dhe konsolidimin e të gjithë veprës që është një shembull i mrekullueshëm i karizmës së krishterë të At Montit.

DY SY, NJË SINERGJI

Prej disa muajsh "Klinika e Syrit" është prezente në Spitalin tonë, një raport bashkëpunimi interesant.

Klinika e syrit është një realitet i lindur në Gjermani dhe që ka arritur një nivel shumë të lartë tashmë edhe në Shqipëri. Aktualisht është partnere në strukturën spitalore të Fondacionit në Tiranë, dhe do të ketë një qendër të dedikuar pranë kampusit tonë spitalo-universitar. Një ofertë e gjerë e shërbimeve shëndetësore ofrohet nga Klinika, falë një përvoje të konsoliduar dhe paisjeve shumë të mira teknologjike. Klinika mund të kontaktohet nëpërmjet faqes së webit www.kgjs.al



KËSHILLTARI GLOBE-TROTTER

Alessandro Lombardi është anëtar i Bordit të Administrimit të Fondacionit ZKM prej shumë vitesh (2009).



Ekspert në çështjet ekonomiko-financiare, prof. Lombardi udhëton në skajet më të ndryshme të botës ku mbikëqyr llogaritë e shumë subjekteve veçanërisht të natyrës fetare. Falë formimit të tij eitk, ushtron një monitorim të çmuar mbi financat e Fondacionit, duke demonstruar një qasje rigoroze dhe lineare. Nuk i mungojnë gjithashtu interesat të tjerë, si historia dhe letërsia. Ai është gjithashtu autor i disa romaneve me karakter historik dhe bashkëautor i "Epoka e ndërgjegjësimit. Përgjegjësia indirekte: një parim i ri për të ndryshuar botën (ed. Messaggero).